



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 5741/prot.

Tiranë, më 18.09.2025

URDHËR

Nr. 480, datë 18.09.2025

PËR

**PËRCAKTIMIN E DATAVE TË ZHVILLIMIT TË OLIMPIADAVE KOMBËTARE NË
ARSIMIN PARAUNIVERSITAR, PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Zhvillimin e olimpiadës kombëtare të lëndës "Matematikë" në arsimin e mesëm të ulët parauniversitar (AMU), për vitin shkollor 2025-2026, si më poshtë:
 - a) Faza e parë, në nivel institucioni arsimor parauniversitar (IAP), më 10 nëntor 2025, ora 12:00.
 - b) Faza e dytë në nivel zyre vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP), më 6 dhjetor 2025, ora 10:00.
 - c) Faza e tretë në nivel kombëtar, më 14 shkurt 2026, ora 10:00.
2. Zhvillimin e olimpiadave kombëtare të lëndëve "Matematikë", "Fizikë", "Kimi", "Biologji", "Informatikë", "Gjuhë shqipe dhe letërsi", "Histori" dhe "Gjeografi", në arsimin e mesëm të lartë (AML) për vitin shkollor 2025-2026, si më poshtë:
 - a) Faza e parë në nivel IAP, përkatësisht:
 - i. Matematika, më 10 nëntor 2025, ora 12:00.
 - ii. Fizika, më 11 nëntor 2025, ora 12:00.
 - iii. Kimia, më 12 nëntor 2025, ora 12:00.
 - iv. Biologjia, më 13 nëntor 2025, ora 12:00.
 - v. Informatika, më 14 nëntor 2025, ora 12:00.
 - vi. Gjuha shqipe dhe letërsia, më 17 nëntor 2025, ora 12:00.
 - vii. Historia, më 18 nëntor 2025, ora 12:00.
 - viii. Gjeografia, më 19 nëntor 2025, ora 12:00.

b) Faza e dytë, në nivel ZVAP-i, përkatësisht:

- i. Matematika, më 6 dhjetor 2025, ora 10:00.
- ii. Fizika, më 13 dhjetor 2025, ora 10:00.
- iii. Kimia, më 20 dhjetor 2025, ora 10:00.
- iv. Biologjia, më 10 janar 2026, ora 10:00.
- v. Informatika, më 17 janar 2026, ora 10:00.
- vi. Gjuha shqipe dhe letërsia, më 24 janar 2026, ora 10:00.
- vii. Historia, më 31 janar 2026, ora 10:00.
- viii. Gjeografia, më 7 shkurt 2026, ora 10:00.

c) Faza e tretë, në nivel kombëtar, përkatësisht:

- i. Matematika, më 14 shkurt 2026, ora 10:00.
- ii. Fizika, më 21 shkurt 2026, ora 10:00.
- iii. Kimia, më 28 shkurt 2026, ora 10:00.
- iv. Biologjia, më 7 mars 2026, ora 10:00.
- v. Informatika, më 21 mars 2026, ora 10:00.
- vi. Gjuha shqipe dhe letërsia, më 28 mars 2026, ora 10:00.
- vii. Historia, më 4 prill 2026, ora 10:00.
- viii. Gjeografia, më 11 prill 2026, ora 10:00.

3. Olimpiadat zhvillohen sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në rregulloren e miratuar me urdhrin nr. 24, datë 23.01.2020, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për miratimin e rregullore për zhvillimin e olimpiadave kombëtare në arsimin parauniversitar dhe pjesëmarrjen e nxënësve në olimpiadat ndërkombëtare".
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTËR

ORJANA OSMANI

